

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-49/10-07

Prishtinë, më 5 prill, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 101 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R E N D D I T E

1. Fjala e hapjes e kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha
2. Fjala e kryetarit të Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu dhe e anëtarëve të tjera të Grupit Negociator dhe
3. Miratimi i Deklaratës.

1. Fjala e hapjes e kryetarit të Kuvendit, z. Kolë Berisha

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për procesin e diskutimit që kishte nisur në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e statusin të Kosovës. I Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara, z. Ahtisari, më 3 prill kishte paraqitur dhe argumentuar raportin e tij për Kosovën. Ky është një moment i rëndësishëm dhe historik për Kosovën. Pardje, për herë të parë, në KS e OKB-së, në formë zyrtare u dëgjua fjala e presidentit të Kosovës z. Fatmir Sejdiu.

Propozimin e z. Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës e mbështetën SHBA-të, Bashkimi Evropian, shtete të tjera të botës dhe vetë sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, z. Ban Ki Mun. Kjo nënkupton fundin e robërisë dhe fillimin e realizimit të sigurt dhe shumë të shpejtë të aspiratave krejtësisht ligjore të këtij populli për të jetuar i lirë dhe sovran në trojet e veta.

Sot jemi mbledhur në këtë seancë plenare, që përmes miratimit të një deklarate, t'i dërgojmë Botës një porosi të qartë për përkrahjen e planit të z. Ahtisaari dhe ta falënderojmë atë për punën e madhe, si dhe të gjithë ata që e përkrahin çështjen tonë.

2. Fjala e kryetarit të Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu dhe e anëtarëve të tjerë të Grupit Negociator

Kryetari e ftoi kryetarin e Kosovës ta merrte fjalën.

Kryetari i Kosovës, dr. **Fatmir Sejdiu** i inforoi deputetët e Kuvendit për zhvillimet e fundit në seancën e KS të OKB-së, si dhe për adresimin e presidentit Ahtisaari para anëtarëve të KS për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Pakoja e përgjithshme e presidentit Ahtisari, e dorëzuar ditë më parë bashkë me dokumentin e rekomandimeve, u është dorëzuar anëtarëve të KS më 26 mars 2007 dhe sipas proceduarave të KS ai e ka paraqitur ekspozenë e tij më 3 prill 2007.

Presidenti Ahtisari në plotëni e ka argumentuar qëndrimin e tij, në raportin për të ardhmen e Kosovës dhe bashkë me pjesën e rekomandimeve politike parashev pavarësinë e Kosovës me një mbikëqyrje ndërkombëtare, me një prani civile ndërkombëtare dhe me trupat e NATO-s për një periudhë të ardhshme.

Në takimin e KS është prezantuar edhe një fjalë imja, që është transmetuar përmes PSSP-së të OKB-së në Kosovë, z. Ryker.

Është e rëndësishme se në këtë proces fillon procedimi i konkretizuar në drejtim të një vendimi konkret që duhet ta marrë KS në mbështetje të këtij dokumenti të rëndësishëm.

Ne, si Kosovë u kemi dhënë mbështetje qëndrimeve të shprehura në pakon e përgjithshme të presidentit Ahtisari edhe dokumentit të rekomandimeve, duke e konsideruar si një dokument të balancuar, në të cilin kemi bërë kompromiset tona për hir të së ardhmes së Kosovës, për hir të së ardhmes së gjithë qytetarëve të saj.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Kosovës në seancën e sotme ta miratojë një deklaratë me të cilën mirëpret në tërësi raportin final të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës z. Ahtisari.

Ne, si Grup i Unitetit kemi bashkëpunuar me Kryesinë e Kuvendit, me shefat e grupeve parlamentare që Kuvendi të dalë me një deklaratë të përbashkët për ta mbështetur këtë proces të rëndësishëm, që hap rrugën e mëtejme për finalizimin e këtij procesi të madh që ka të bëjë me lirinë dhe me pavarësinë e vendit tonë.

Kryetari e ftoi kryeministrin e Kosovës ta merrte fjalën.

Kryeministri **Agim Çeku** tha se Qeveria e Kosovës e mbështet propozimin që Kuvendi i Kosovës ta miratojë një deklaratë me të cilën i mbështet raportin dhe rekomandimet e z. Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Ky dokument, pra, garanton krijimin e shtetit të Kosovës dhe garanton integritetin territorial të Kosovës.

Ne do t'i japim mbështetje punës së Ekipit Negociator me të gjithë potencialet tona, të përfshira për përfaqësimin sa më besnik të interesave të popullit të Kosovës.

Pavarësisht nga dallimet politike që kemi, ne kemi kultivuar një vlerë të jashtëzakonshme dhe esenciale për të ardhmen e shtetit të ri, unitetin për çështje madhore në interes kombëtar.

Kryetari e ftoi anëtarin tjetër të Grupit Negociator ta merrte fjalën.

Hashim Thaçi, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës bëri një vështrim historik të përpjekjeve të popullit të Kosovës për çlirim e tij nga okupatori.

Kosova me njojjen e pavarësisë do t'i marrë edhe përgjegjësitë që i takojnë, por pas pavarësisë vijnë edhe mundësi të reja dhe një epokë e re, që kërkon prej nesh më shumë punë për të arritur stabilitet, përparim, jetë më të mirë për qytetarët dhe për vendin tonë.

Sot po i vëmë themelet e memorialit më të rëndësishëm dhe më madhështor për atë që kemi sakrifikuar bashkërisht dhe për ata që kanë sakrifikuar jetën. Por, për ta respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës, sot kërkohen lidership dhe konsensus.

Kemi besimin e palëkundur se të bashkuar mund ta tejkalojmë çdo sfidë. Uniteti që ka mbizotëruar në mes popullit të Kosovës dhe politikës në luftën tonë të drejtë ka qenë i palëkundur. Ky unitet, që nuk ka qenë kurrë më i fuqishëm se sot, ky unitet që nuk ka qenë kurrë më i madh se sot, është hap i madh dhe i sigurt drejt ndërtimit të shtetit tonë modern.

Kosova mirëpret dokumentin e presidentit Ahtisari. Kosova mirëpret prezencën civile ndërkombëtare dhe NATO-n dhe merr përgjegjësitë për implementimin e marrëveshjes së presidentit Ahtisari.

Kryetari e ftoi anëtarin tjetër të Grupit Negociator ta merrte fjalën

Veton Surroi, kryetar i Partisë Reformiste ORA - Është një ndër i veçantë që këtu t'i ndajmë këto momente solemne së bashku, sepse ky rrugëtim me çfarëdo dallimi të interpretuar në këto vite, megjithatë ka qenë rrugëtim i përbashkët.

Në 100 vjetët e kaluara është bërë një përpjekje e jashtëzakonshme e shumë lëvizjeve dhe e shumë individëve për të qenë të barabartë. Kërkesat për barazi, për barazinë e Kosovës, të qytetarëve të saj e të popullit të saj - posaçërisht u ritheksuan pas Luftës së Dytë Botërore. Ajo çka nuk u arrit në ish –Jugosllavi, që Kosova të bëhet e barabartë me popujt e tjerë po mbërrihet sot - Kosova po shndërrohet në shtet të barabartë me popujt e tjerë në një bashkësi të lirë shtetesh, në një botë krejtësisht të re.

Njëkohësish, sot është ndër që çështja e Kosovës të jetë shndërruar në çështje që bashkon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, çështje që bashkon edhe ato shtete brenda Bashkimit Evropian, të cilat mund të kenë pasur dyshime, çështje që bashkon kulturat e ndryshme, bashkon shtetet e krishtera, ato islamike, ato me sfond budist. Kosova është çështje globale që po i bashkon të gjitha këto vende dhe të gjitha ato lëvizje të cilat kanë qenë liridashëse dhe kanë krijuar shtetet e veta.

Kuvendi i Kosovës, përmes kësaj deklarate, thekson se Kosova është e gatshme për zgjerim të këtij partneriteti në këtë shekull, në këtë bashkësi të lirë shtetesh.

3. Miratimi i deklaratës

Kryetari i Kuvendit, z. **Kolë Berisha** para deputetëve të Kuvendit e paraqiti tekstin e deklaratës.

Kuvendi me njëqind (100) vota për dhe një (1) kundër miratoi **Deklaratën** si vijon:

- Kuvendi i Kosovës, përmes kësaj deklarate mirëpret raportin final të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars 2007, duke besuar se rekomandimet e tij paraqesin një zgjidhje të drejtë dhe të balancuar, që është në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës.
- Pranon dhe zotohet ta implementojë plotësisht Propozimin gjithëpërfshirës të marrëveshjes për statusin e Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, më 26 mars 2007 dhe deklaron, nën supozimin që Marrëveshja është e pranueshme për Këshillin e Sigurimit, se dispozitat që i përban marrëveshja do të janë ligjësish të obligueshme për Kosovën.
- Mirëpret pa rezervë praninë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë që do të krijohet në Kosovë, siç parashihet në Marrëveshje dhe zotohet se do të bashkëpunojë dhe do ta mbështesë këtë prani në çdo mënyrë të mundshme, përderisa kjo prani ndërkombëtare civile dhe e sigurisë t'i kryejë detyrat që i janë dhënë në Marrëveshje.

Deputetët e Kuvendit u ngritën në këmbë dhe me duartrokite shprehën kënaqësinë për miratimin e kësaj deklarate.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 10:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoï

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale